



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË
KOMITETI SHQIPTAR I BIRËSIMEVE

RELACION SHPJEGUES

1. LISTË PËRMBAJTJE E RAPORTEVE TË MONITORIMIT PËR PERIUdhËN JANAR-DHJETOR 2023

- ANEKSI nr.2 “Raporti mbi Ekzekutimin e Buxhetit në nivelin e Programit të Buxhetit”
- ANEKSI nr.2.1 “Shpenzimet e Programit sipas kapitujve”
- ANEKSI nr.3 “Raporti I performances së produkteve të programit”
- ANEKSI nr.3.1 “Raporti performances së produkteve të programit sipas artikujve”
- ANEKSI nr.3.2 “Devijacioni I kostos për njësi në vite”
- ANEKSI nr.4 “Raporti i realizimit të treguesve të performancës të programit”

2. HYRJJE

Në zbatim të Shtojcës nr.3, të Udhëzimit nr.14, datë 30.05.2023 “Për procedurat standarte të monitorimit të buxhetit në Njësitë e Qeverisjes Qëndrore”, paraqesim në mënyrë të përmbledhur procesin e monitorimit të kryer gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, si në vijim:

Programi Shërbimet për çështjet e birësimeve në përmbushje të politikës së programit të vet ka kryer të gjitha shpenzimet e nevojshme në përputhje me Ligjin Nr.9936, datë 02.06.2016 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, Ligjin Nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, si dhe udhëzimet plotësuese të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë në zbatim të tij.

EMP me në krye DEMP ka realizuar në mënyrë të vazhdueshme monitorimin e performancës së programit, konkretisht të politikës së programit, si dhe realizimit të shpenzimeve buxhetore në funksion të saj për të gjithë artikujt kontabël përkatës. Paralelisht është bërë edhe monitorimi i buxhetit dhe nivelit të shpenzimeve në përputhje me produktet e realizuara.

3. INFORMACION BUXHETOR I AGREGUAR

Gjatë periudhës raportuese, në zbatim të Ligjit nr 84/2022, “Për buxhetin e vitit 2023” në zbatim të udhëzimit të ministrit të Financave nr.9, datë 20.03.2018, “Për procedurat standarte të zbatimit të buxhetit” si dhe Udhëzimit plotësues të Ministrit të Financave dhe Ekonomisë Nr.2, dt.19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, janë rialokuar fonde buxhetore brenda programit. Konkretisht:

- a. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.3561/1 prot, datë 21.02.2023 “Dërgohet transferim fondi për vitin 2023”, vlera prej 24.000 lekësh u pakësua nga llogaria ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) dhe shtimi i saj në llogarinë ekonomike 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Këto fonde sipas pikës 14, të VKM 673/2020, do të përdoren për kryerjen e pagesës për kompensimin e titullarit të institucionit të telefonisë celulare.
- b. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2800/1 prot, datë 21.02.2023 “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë”, dhe shkresën nr.2800/2 prot, datë 23.02.2023 “Miratim limiti” për institucionin tonë është miratuar detajimi I buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë.
- c. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.9276/1 prot, datë 30.05.2023 “Dërgohet transferim fondi për shpenzimet kapitale”, për institucionin tonë është miratuar transferimi i fondi prej 39.000 lekë nga projekti M140033 “Blerje pajisje zyre” në projektin 18AR302 “Blerje pajisje elektronike”.
- d. Me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.12310/1 prot, datë 24.07.2023 “Dërgohet miratimi i akordimit të fondeve shtesë”, për institucionet në vartësi të Ministrisë së Drejtësisë dhe për institucionin tonë janë miratuar akordimet e fondeve shtesë prej 700.000 lekë në llogarinë 600 dhe 100.000 lekë në llogarinë 601.

Numri I punonjësve sipas strukturës së miratuar nga Kryeministri nr.134 Prot. datë 23.11.2021 dhe strukturës së fundit të miratuar nga Kryeministri me kategoritë e ndryshuara nr.227 Prot. datë 15.12.2023, për Intitucionin tonë, për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 9 punonjës së bashku me Kryetarin e KSHB. Në total bashkë me punonjësit mbështetës bëhen 12 punonjës. Për periudhën Prill- 18 Shtator 2023, Specialistja (Shkenca sociale) Neranxa Dranga – me kategori page të ndryshuar IV-I, ka qënë me lejë lindje dhe Specialistja (Buxhet Financë) me kategori page të ndryshuar IV-I, ka qënë me raport paaftësie të paguar nga Instituti I Sigurimeve Shoqërore Tiranë, për periudhën Qershor- 08 Gusht 2023.

4. PERFORMANCA E BUXHETIT NË NIVELIN E PROGRAMIT

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, është monitoruar vazhdimisht buxheti i miratuar dhe në zbatim të ligjit nr.84/2022 “Për buxhetin e vitit 2023”, Udhëzimit Plotësues nr.2, datë 19.01.2023 “Për zbatimin e buxhetit të vitit 2023”, me kërkesë të KSHB, Ministria e Financave dhe Ekonomisë miratoi rialokimin e shumës prej 24.000 lekë nga artikulli 602 (Mallra dhe shërbime) në artikullin 606 (Transferta te buxhete familjare dhe individë). Nga ana tjetër, Ministria e Financave dhe Ekonomisë ka miratuar fondin e veçantë prej 100.000 lekë për vitin 2023.

Realizimi I buxhetit të Institucionit tonë krahasuar me planin vjetor të buxhetit është e shprehur në përqindje 90 %.

Në Aneksin nr.2 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi sipas klasifikimit ekonomik dhe sipas produkteve të programit buxhetor si më poshtë :

Emri i Grupit		Ministria e Drejtësisë		Kodi i grupit		14							
Emri i Institucionit		Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Kodi i programit		01160							
EMËRTIME		Shpenzimet e Programit											
		Viti paraardhës 2022		Periodha raportuese		Periodha raportuese		Periodha raportuese		Periodha raportuese		Ndryshimi Vjetor (Plan - Fakt)	% e realizimit
		Shpenzime Faktike	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Fillestar Vjetor Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Plani Vjetor i Rishikuar Viti 2023	Struktura e shpenzimeve në %	Ndryshimi i planit vjetor	Shpenzime Faktike të Periudhës/Progresive	Struktura e shpenzimeve në %			
(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	7 (5-3)	(8)	(9)	10 (5-8)	11 (8/5)			
Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik													
Kodi i Programit	Emërtimi												
600	Paga	7,005,421.00	97	9,880,000	97	10,580,000	97	700,000	10,274,886.00	97	305,114	97	
601	Sigurime Shoqërore	1,186,101.00	95	1,680,000	95	1,780,000	95	100,000	1,698,259.00	95	81,741	95	
602	Mallra dhe Shërbime të Tjera	2,447,104.00	71	4,000,000	71	3,976,000	71	-24,000	2,801,677.00	71	1,174,323	71	
603	Subvencione	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
604	Transferta Korente të Brendshme	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
605	Transferta Korente të Huaja	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
606	Trans per Buxh. Fam. & Individ	174,000.00	60	0	60	124,000	60	124,000	74,000.00	60	50,000	60	
	Nëntotali Shpenzime Korente	10,812,626.00	90	15,560,000	90	16,460,000	90	900,000	14,848,822.00	90	1,611,178	90	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	174,200.00	58	200,000	58	200,000	58	0	116,700.00	58	83,300	58	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	174,200.00	58	200,000	58	200,000	58	0	116,700.00	58	83,300	58	
230	Kapitale të Patrupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
231	Kapitale të Trupëzuara	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të hua	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
	Totali i Shpenzimeve Kapitale	174,200.00	58	200,000	58	200,000	58	0	116,700.00	58	83,300	58	
	Totali i Shpenzimeve Buxhetore të Programit	10,986,826.00	90	15,760,000	90	16,660,000	90	900,000	14,965,522.00	90	1,694,478	90	
	Shpenzime Korente nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	Shpenzime Kapitale nga të Ardhurat Jashtë limitit (Kap 06)	0.00							0.00				
	Totali i Shpenzimeve të Programit	10,986,826.00							14,965,522.00				
Shpenzimet sipas produkteve të programit buxhetor													
Artikulli	Emërtimi												
	Totali i Shpenzime Korente	10,812,626.00	98	15,560,000	99	16,460,000	99	900,000	14,848,822.00	99	1,611,178	90	
Kodi i produktit	Emërtimi												
91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	10,812,626.00	98	15,560,000	99	16,460,000	99	900,000	14,848,822.00	99	1,611,178	90	
	Totali Shpenzime për Investime	174,200.00	2	200,000	1	200,000	1	0	116,700.00	1	83,300	58	
Kodi i produktit	Emërtimi												
18AR302	Pajisje elektronike të blera	101,000.00	1	120,000	1	159,000	1	39,000	79,500.00	1	79,500	50	
M140033	Pajisje per zyra	73,200.00	1	80,000	1	41,000	0	-39,000	37,200.00	0	3,800	91	
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të brendshëm	174,200.00	2	200,000	1	200,000	1	0	116,700.00	1	83,300	58	
Kodi i produktit	Emërtimi												
	Nëntotali Shpenzime Kapitale me financim të huaj	0.00	0	0	0	0	0	0	0.00	0	0	0	
Kodi i produktit	Emërtimi												
Kodi i produktit	Emërtimi												
	Totali i Shpenzimeve të Programit	10,986,826.00		15,760,000		16,660,000		900,000	14,965,522.00		1,694,478		

Në Aneksin nr.2/1 paraqiten ekzekutimi I buxhetit në nivel programi buxhetor dhe realizimi i artikujve buxhetore në përqindje si më poshtë

RAPORTI 2/1 Shpenzimet e programit sipas kapitujve																
Periudha e Raportimit 12-2023																
Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Kapitullit	Emërtimi i Kapitullit	Periudha raportuese	Buxheti	Artikujt buxhetore									Total
							230	231	600	601	602	603	604	605	606	
							Shpenzime Kapitale të Patrupëzuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subveçnet	Të Tjera Transfer.Korr ente Brendshme	Transfer .Korr ente të Huaja	Transferta për Buxhetet Familjare dhe Individët	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2023	Plani fillestar	0	200,000	9,880,000	1,680,000	4,000,000	0	0	0	15,760,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2023	Plani i rishikua	0	200,000	10,580,000	1,780,000	3,976,000	0	0	124,000	16,660,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2023	Fakti	0	116,700	10,274,886	1,698,259	2,801,677	0	0	74,000	14,965,522	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	01	Nga Buxheti	2023	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2023	Plani fillestar	0	200,000	9,880,000	1,680,000	4,000,000	0	0	0	15,760,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2023	Plani i rishikua	0	200,000	10,580,000	1,780,000	3,976,000	0	0	124,000	16,660,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2023	Fakti	0	116,700	10,274,886	1,698,259	2,801,677	0	0	74,000	14,965,522	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Total	2023	Angazhime	0	0	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Ndryshimi ne vlere			2023		0	83,300	305,114	81,741	1,174,323	0	0	50,000	1,694,478	
14	01160	Realizimi ne %			2023		0	58	97	95	71	0	0	60	90	

- Nuk ka diferenca në realizim në llogarinë ekonomike 600 (Paga) dhe 601 (Sigurime shoqërore). Përqindja e realizimit është përkatësisht 97 % dhe 95%.
- Sa i takon llogarisë ekonomike 602 (Mallra dhe shërbime) ka diferenca. Përqindja e realizimit është 71% pasi nuk janë realizuar të gjitha procedurat e prokurimit, të parashikuara gjatë 12-mujorit të vitit 2023. Procedurat e prokurimit janë realizuar 13 nga 20 të parashikuara. Nga ana tjetër, edhe fondet e parashikuara për shërbime nga të tretët kanë qënë më të ulëta se mesatarja e llogaritur e tre viteve të fundit. Për zërin honorare, për anëtarët e Këshillit Drejtues, janë realizuar 11 mbledhje nga 12 mbledhje që bëhet parashikimi vjetor për mbledhjet nga anëtarët e Këshillit Drejtues.
- Po ashtu, fondi prej 124.000 lekë miratuar në llogarinë ekonomike 606 (Transferta për buxhete familjare ose individë). Është shpenzuar pjesërisht pasi ka ndodhur vetëm një rast për realizimin e tij (raste të situatave të vështira, dalje në pension etj), dhe pjesa tjetër e fondit prej 24.000 lekë është përdorur për kompensimin e telefonisë celulare të titullarit të institucionit. Përqindja e realizimit është 60 %, në masë të pjesshme.
- Lidhur me fondet e investimeve në llogarinë ekonomike 231 (Investime kapitale të brendshme), realizimi I një procedurë blerje për pajisje zyre dhe një procedurë blerje për pajisje elektronike. Të dyja procedurat janë likuiduar dhe janë mare në dorëzim.

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, programi Shërbimet për çështjet e birësimeve, ka realizuar veprimtarinë e tij duke e mbështetur politikën e programit mbi një qëllim kryesor, konkretisht:

***Qëllimi** – Sigurimi dhe monitorimi i fëmijëve të mitur, të shpallur të braktisur me vendim gjykatë, të birësuar nga familje shqiptare që jetojnë brenda ose jashtë vendit si dhe nga familje të huaja, duke garantuar dhe respektuar të drejtat e tyre themelore.*

Ky qëllim është përmbushur në masën 100%.

Në realizimin e plotë të tij ka ndikuar puna e bërë gjatë periudhës raportuese nga ana e stafit të KSHB, duke mbajtur gjithmonë parasysh dhe garantuar interesin më të lartë të fëmijës. Gjithashtu, është bashkërenduar puna me të gjitha institucionet që operojnë në fushën e birësimit, agjencitë ndërmjetësuese për birësimet ndërvendase si dhe me të gjitha institucionet e përkujdesit social me qëllim realizimin e proceseve birësuese në përputhje me bazën ligjore në fuqi si dhe brenda një kohe sa më të shkurtër të mundshme.

Në funksion të këtij qëllimi, programi ynë ka patur tre objektiva për realizim, si më poshtë:

1. **Objektivi 1.1** – Përfundimi me sukses i dhënies për birësim çifteve shqiptare dhe atyre të huaja të 22 fëmijëve gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023. **Ky objektivi është përmbushur plotësisht.** Gjatë periudhës raportuese, KSHB ka shqyrtuar brenda afateve ligjore të gjitha kërkesat për birësim.

2. **Objektivi 1.2** – Blerje pajisje elektronike. **Ky objektivi është realizuar dhe likuaduar**, është kryer blerja e pajisjes elektronike si dhe është marrë në dorëzim – Kompjuter Desktop, 1 (një) copë.

3. **Objektivi 1.3** – Blerje pajisje zyre. **Ky objektivi është realizuar dhe likuaduar**, është kryer blerja e pajisjeve të zyrës si dhe është marrë në dorëzim - konkretisht është blerë një tavolinë zyre.

Sipas Aneksive nr.3 Raporti I performances së produkteve të programit dhe nr.3/1 Raporti I performances së produkteve të programit sipas artikujve si më poshtë :

Periodha e Raportimit 12-2023																	në/lekë	
Emri i Grupit		Ministria e Drejtësisë		Kodi i grupit		14												
Emri i		Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve		Kodi i programit		01160												
Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Njësia matëse	Viti paraardhës			Periodha Rapotuese			Periodha Rapotuese			Periodha Rapotuese			Deviacioni i Kostos për Njësi			
			Sasia Faktike (Viti paraardhës)	Shpenzimet Faktike (sipas vitit paraardhës)	Kosto për Njësi (sipas vitit paraardhës)	Sasia (sipas planit Fillestar Vjetor)	Shpenzimet (sipas planit Fillestar Vjetor)	Kosto për Njësi (sipas planit Fillestar të vitit)	Sasia (sipas planit të rishikuar të vitit korent)	Shpenzimet (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Kosto për Njësi (sipas /nplanit të rishikuar të vitit korent)	Sasia Faktike (në /nfund të vitit korent)	Shpenzimet Faktike /n(në fund të vitit korent)	Kosto për Njësi Faktike /n(në fund të vitit korent)	13=(12)-(3)	14=(12)-(6)	15=(12)-(9)	
			(1)	(2)	(3)	(4)	(5)	(6)	(7)	(8)	(9)	(10)	(11)	(12)	(13)	(14)	(15)	
Produktet e realizuara me shpenzimet buxhetore të programit																		
91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	Numër	14	10,812,626	772,330	25	15,560,000	622,400	22	16,460,000	748,182	22	14,848,822	674,946	-97,384	52,546	-73,236	
18AR302	Pajisje elektronike të blera	Numër	1	101,000	101,000	2	120,000	60,000	1	159,000	159,000	1	79,500	79,500	-21,500	19,500	-79,500	
M140033	Pajisje per zyra	Numër	2	73,200	36,600	0	80,000	0	1	41,000	41,000	1	37,200	37,200	600	37,200	-3,800	
T	Total			10,986,826			15,760,000			16,660,000			14,965,522					
Produktet e realizuara nga përdorimi i të ardhurave jashtë limitit (Nga kapitulli 06)																		

Periodha e Raportimit 12-2023																	
Kodi i Ministrisë	Kodi i Programit	Emërtimi i Programit	Kodi i Produktit	Emërtimi i Produktit	Tipi i Buxhetit	Sasia	Artikujt buxhetore										
							Total	230	231	600	601	602	603	604	605	606	
								Shpenzime Kapitale të Patrupezuara	Shpenzime Kapitale të Trupëzuara	Pagat	Kontrib.e Sigurimeve Shoqërore	Mallra dhe Shërbime	Subvecinet	Të Tjera Transfer.Korrente të Huaja Brendshme	Transfer.Korrente të Huaja	Transferata për Buxhetet Familjare dhe Individët	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	Plani fillestar	25	15,560,000	0	0	9,880,000	1,680,000	4,000,000	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	Plani i rishikuar	22	16,460,000	0	0	10,580,000	1,780,000	3,976,000	0	0	0	124,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	91404AA	Kërkesa për birësim të shqyrtuara	Fakti	22	14,848,822	0	0	10,274,886	1,698,259	2,801,677	0	0	0	74,000	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR302	Pajisje elektronike të blera	Plani fillestar	2	120,000	0	120,000	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR302	Pajisje elektronike të blera	Plani i rishikuar	1	159,000	0	159,000	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	18AR302	Pajisje elektronike të blera	Fakti	1	79,500	0	79,500	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140033	Pajisje per zyra	Plani fillestar	0	80,000	0	80,000	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140033	Pajisje per zyra	Plani i rishikuar	1	41,000	0	41,000	0	0	0	0	0	0	0	
14	01160	Sherbimet per Çeshtjet e Biresimeve	M140033	Pajisje per zyra	Fakti	1	37,200	0	37,200	0	0	0	0	0	0	0	
Totali i shpenzime							Plani fillestar	15,760,000	0	200,000	9,880,000	1,680,000	4,000,000	0	0	0	
Totali i shpenzime							Plani i rishikuar	16,660,000	0	200,000	10,580,000	1,780,000	3,976,000	0	0	0	124,000
Totali i shpenzime							Fakti	14,965,522	0	116,700	10,274,886	1,698,259	2,801,677	0	0	0	74,000

Sa i takon realizimit të produkteve për secilin objektiv, situata paraqitet si në vijim:

Objektivi 1.1 Ka patur një produkt të parashikuar:

Produkti 91404AA – Kërkesa për birësim të shqyrtuara. *Ky produkt është përmbushur në masën 100%* krahasuar me planin vjetor .

Sasia (sipas planit 12/mujor)	25
Sasia (sipas planit të rishikuar 12/mujor)	22
Sasia faktike (në fund të 12/mujorit të vitit 2023)	22

Produkti 18AR302– Pajisje elektronike të blera. *Për këtë produkt është* është realizuar blerja e pajisjes elektronike – Kompjuter Desktop është likuajduar dhe është bërë hyrje ne magazinë. Përqindja e realizimit është 50%.

Tek specifikimet Teknike Standarde për vitet 2023-2024, në faqen zyrtare të AKSHI-t, pika 2, Vlerat e pajisjeve standarde janë sipas parashikimit të dalë nga studimi i tregut. Këto vlera mund të ulen pas procedurës së prokurimit me marrëveshjen kuadër. Në linkun: <https://akshi.gov.al/standarde-tik/specifikime-teknike/> , paraqiten vlera të tjera të kompjuterave. Për këtë arsye është bërë dhe transferim fondi për Produktin 18AR302. Gjatë procesit të prokurimit në APP, rezultuan vlera më të vogla dhe për pasojë u shpall fitues Operatori me çmim më të ulët.

Produkti M140033 – Pajisje zyre të blera. *Për këtë produkt është realizuar procedura e prokurimit,* është likuajduar blerja e pajisjes dhe është bërë hyrje ne magazinë. *Përqindja e realizimit është 91%.*

Birësimet gjate 2022 janë 35 në total nga të cilat janë mbartur edhe femijët e ardhur nga vitet e mëparshme.

Për vitin aktual janë birësuar 22 fëmijë.

Qëllimi i KSHB është realizuar në masën 100% .

Shpenzimet për këto produkte janë planifikuar me fondet e miratuara nga Buxheti i Shtetit në fillim të vitit 2023.

Të gjitha procedurat e birësimit të realizuara brenda dhe jashtë vendit kanë rezultuar të sukseshme dhe përshtatja prind-fëmijë është arritur plotësisht.

Po ashtu, të gjithë treguesit e performancës në nivel objektiv janë realizuar.

Në përfundim të analizës së realizimit të qëllimit, objektivave dhe produkteve të programit, mund të themi se gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, KSHB ka bërë një punë mjaft të mirë për përmbushjen e politikës së programit të vet. Institucioni është angazhuar maksimalisht për vijimin e detyrave të parashikuara, duke përmbushur plotësisht qëllimin dhe objektivin kryesor të KSHB, që është shqyrtimi i të gjitha kërkesave të aplikantëve birësues, si dhe realizimi i proceseve birësuese për të gjithë fëmijët dosjet e të cilëve janë depozituar ne KSHB duke garantuar në çdo rast interesin më të lartë të fëmijëve.

Theksojmë se, gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, për institucionin tonë nuk paraqitet asnjë detyrim i prapambetur i krijuar rishtazi apo i mbartur. Të gjitha shpenzimet janë kryer në kohë dhe janë përballuar me fondet nga Buxheti i Shtetit.

5. PROJEKTET KAPITALE

Në përfundim, sqarojmë se, KSHB nuk ka parashikuar dhe realizuar asnjë objekt investimi për projekte të mëdha kapitale me financim brendshëm ose të huaj. Gjithashtu, institucioni nuk siguron të ardhura jashtë limitit dhe si rrjedhojë nuk ka financuar asnjë shpenzim nga ky burim të ardhurash.

6. NDRYSHIMET NË BUXHET

Në zbatim të VKM nr. 325, datë 31.05.2023 “Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në disa institucione të administratës publike”, VKM nr.326, datë 31.05.2023 “Për pagat e punonjësve mbështetës dhe punonjësve të specialiteteve të tjera në institucione të administratës publike”, Institucionit tonë I janë akorduar fondet shtesë nga rritja e pagave shprehur në vlera në tabelën më poshtë.

Gjithashtu me shkresën e Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë nr.2800/1 prot, datë 21.02.2023 “Dërgohet detajimi i fondit të veçantë”, dhe shkresën nr.2800/2 prot, datë 23.02.2023 “Miratim limiti” për institucionin tonë është miratuar detajimi I buxhetit për fondin e veçantë prej 100.000 lekë. Gjithsej janë shtuar fonde prej 900.000 lekësh, në llogaritë respektive si vijon :

- Për llogarinë ekonomike 600: 700.000 lekë
- Për llogarinë ekonomike 601: 100.000 lekë
- Për llogarinë ekonomike 606: 100.000 lekë

Ndryshimet e buxhetit(shtesat) paraqiten për periudhën raportuese në formë tabele, sipas llogarive ekonomike si në vijim:

Në lekë

	Totali	Llog. 600	Llog. 601	Llog. 602	Llog. 606	Llog. 231
Buxheti (Plan)	15.760.000	9.880.000	1.680.000	4.000.000	24.000	200.000
Buxheti (shtesat në plan)	900.000	700.000	100.000		100.000	
Nryshimet në buxhet(shtesat)	16.660.000	10.580.000	1.780.000	3.976.000	124.000	200.000
Realizimi fakt	14,965,522	10,274,886	1,698,259	2,801,677	74,000	116,700

Realizimi I buxhetit të Institucionit tonë për periudhën Janar-Dhjetor 2023 është 14,965,522 lekë, krahasuar me buxhetin total të vitit 16.660.000 lekë, e shprehur në përqindje është 90%.

7. PËRFUNDIME

Përqindja e realizimit të buxhetit për periudhën raportuese është në masen 90 %.

Të ardhurat sekondare të sigururara nga tarifat e birësimit gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023 janë derdhur 100% në Buxhetin e Shtetit. Të ardhurat e Institucionit tonë për periudhën 12-mujore janë 1.273.407,3 lekë

Gjatë periudhës Janar-Dhjetor 2023, institucioni ynë, në kuadër të monitorimit të buxhetit, ka përgatitur në fund të vitit Evidencën e shpenzimeve së bashku me relacionin përkatës.

HARTOI:
SPECIALIST (BUXHET - FINANCË)

Elda Liçkollari

MIRATOI:
KRYETAR

Alma Laci